



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

Nr. I prot. 2344
Dt. 11.07.2025
RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Përkrahja e bizneseve në agroturizëm dhe ushqimet tradicionale në komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, përmes kësaj thirrjeje iu bën ftesë publike bizneseve që merren me agroturizëm dhe me ushqime tradicionale, që veprojnë në komunën e Rahovecit, të aplikojnë për të përfituar nga skema e mbështetjes e cila do të ofrohet përmes subvencioneve me mjete financiare.

1. Synimet e thirrjes

Synimi i përgjithshëm i thirrjes është: zhvillimi ekonomik lokal përmes përkrahjes dhe promovimit të agroturizmit në komunën e Rahovecit.

Synimet specifike të kësaj thirrjeje janë:

1. Përkrahja dhe zhvillimi i agroturizmit në komunën e Rahovecit;
2. Rritja e numrit të bizneseve në komunën e Rahovecit;
3. Gjenerimi i vendeve të reja të punës.

2. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme indikative për këtë thirrje është 20,000.00€

Nga kjo thirrje publike do të përkrahen të gjitha bizneset të cilat merren me zhvillimin e agroturizmit në komunën e Rahovecit.

3. Kriteret e aplikimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha bizneset të cilat merren me këto aktivitete

Aplikantët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Kosovës, banor/e rezident i komunës së Rahovecit (dëshmohet me kopjet e letërnjoftimit);
- Mund të jetë biznes start-up apo biznes ekzistues;
- Bizneset e regjistruara duhet të kenë te kryera të gjitha obligimet ndaj Komunës së Rahovecit.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

Vërejtje: bizneset, pas shpalljes përfitues të kësaj thirrjeje, obligohen që të nënshkruajnë kontratë me Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

-Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për personat juridikë:

- Formulari i aplikimit;
- Projekt-propozimi;
- Certifikata e biznesit së bashku me informatat;
- Kopja e letërnjoftimit të pronarit ose e përfaqësuesit të autorizuar;
- Vërtetim që i ka të shlyera obligimet ndaj Komunës së Rahovecit;
- Konfirmimi i xhirollogarisë bankare në emër të biznesit;
- Vërtetimi nga ATK-ja.

Vërejtje: Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet pas vlerësimit të gjendjes faktike në teren nga komisioni përkatës.

- Përfitues të këtij subvencionit nuk mund të jenë ato biznese që janë përkrahur në 3 (tre) vitet e fundit.

4. Mënyra e aplikimit

Aplikacioni mund të shkarkohet në faqen ueb të Komunës së Rahovecit, ose të tërhiqet në zyrën e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

Aplikimi do të jetë online në adresat elektronike: fidan.hoti@rks-gov.net dhe tourism.rahovec@gmail.com në formën e PDF dhe në formën fizike në dy kopje në zyrën e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Komuna e Rahovecit, rr. "Dëshmorët e Pashtrikut" p.n. kati i parë.

Për informata shtesë nr. kontaktues: +383 49 884-575

5. Afati për dorëzimin e aplikacionit

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është nga data 14.7. 2025 deri më 28.7.2025.